



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Maj 2025

Data 26.05.2025 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 28.04.2025 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Prill 2025..
- 3.Të ndryshme.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Maj 2025, u zhvillua me datë 26.05.2025 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 19 këshilltarë, (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha,Kastriot Shkjau, Vjollca Zagani,Majlinda Ndreca,Besmir Kapaj, Arsen Mehmeti,Roberto Trushi,Frano Prenga, Albina Livadhi,Ermir Tahiri,Sanije Salja, Ervis Shimaj) korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj - kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës:

Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundër, zero vota abstenim.

Këshilltarët që votuan Pro rendin e ditës (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha,Kastriot Shkjau, Vjollca Zagani,Majlinda Ndreca,Besmir Kapaj, Arsen Mehmeti,Roberto Trushi,Frano Prenga, Albina Livadhi,Ermir Tahiri,Sanije Salja, Ervis Shimaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 28.04.2025 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 28.04.2025 nga Z.Ervis Shimaj.Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Meliha



Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkja, Vjollca Zagani, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ermir Tahiri, Sanije Salja, Ervis Shimaj)

Z. Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Prill 2025..

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj. Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike, e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se projekt vendimi është hartuar bazuar ne ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Ajo shprehet se bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Prill 2025 , familje 137, me 450,753 lekë, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Prill 2025 janë shpallur fitues, 975 familje, me fond 7,528,472 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 451,708 lekë.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 19 vota Pro. zero kundër dhe zero abstenim.

Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Rita Preçi, Ornella Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkja, Vjollca Zagani, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ermir Tahiri, Sanije Salja, Ervis Shimaj)

Pika 3: Të ndryshme.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për pyetje apo diskutime të ndryshme në adresë të Bashkisë apo Këshillit Bashkiak.

Z. Ermir Tahiri pyet: Jam banor i fshatit Kosmaç dhe kërkoj që të bëhet pastrimi i kanaleve në lagjet e fshatit si dhe afër qendres së fshatit.

Z. Ervis Molla- Zv/Kryetar Bashkie, sqaron se do të shikohet shqetësimi i ngritur dhe do të merren masa për zgjidhjen e këtij problemi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari këshillit e deklaroi të mbyllur mbledhjen e datës 26.05.2025 pasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera.



Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA

Këshilltarët:

1. Enris Shinoj
2. Melika Gjoni
3. Meli Koptanaj
4. Frano Prenga
5. Enrica Gjoni
6. Ornela Lleshi
7. Kajlinda Miko
8. Rita Gresi
9. Leonora Prenga
10. Edna Trosh
11. Kustriot Shkja
12. Emir Tohir
13. Vjolla Zogaj
14. Alina Livihi
15. Mirela Vasija

16. Mont Bish
17. Vange Sogaj
18. Besmir Kogej
19. Arsen Mehmeti
20. _____
21. _____
22. _____
23. _____
24. _____
25. _____
26. _____
27. _____
28. _____
29. _____
30. _____
31. _____